



REPUBLIKA E SHQIPËRISE  
MINISTRIA E KULTURËS  
KËSHILLI KOMBËTAR I RESTAURIMEVE

**VENDIM**

**Nr. 32, dt. 23.02.2016**

Në mbështetje të ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, “Për Trashëgiminë Kulturore”, i ndryshuar, Këshilli Kombëtar i Restaurimeve, në mbledhjen e datës 23.02.2016, pasi shqyrtoi projektin e diskutuar më parë dhe në Këshillin Shkencor të Institutit të Monumenteve të Kulturës,

**VENDOSI:**

1. Miratimin e projektit të rikonstruksionit për objektin “Ish Kinemaja, Berat” me këto kushte:  
*Veshja me gurë në fasadë të jetë me nuanca të lehta bezhë dhe pa kontraste.*  
*Fasada e xhamit të realizohet me profile të padukshme nga ana e jashtme.*
2. Ngarkohet Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurisë Kulturore për regjistrimin e këtij vendimi.
3. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.  
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**SEKRETAR I KKR**

**ARTA DOLLANI**

**KRYETAR**  
**MIRELA KUMBARO FURXHI**

